

VENDIM
Nr. 6, datë 16.12.2019

PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE TË KRIJUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të vendimit nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, Komiteti Ndërmintoror i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore në qarqet e Durrësit, Lezhës dhe Tiranës, i mbledhur sot më 16.12.2019,

VENDOSI:

1. Mbetjet inerte të krijuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë të transportohen dhe të depozitohen në venddepozitim të Porto-Romanos, Bashkia Durrës.

2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve të marrë masat e nevojshme për inkapsulimin e zonës së Porto-Romanos dhe rijetësimin e kësaj zone me procedurë të përshpejtuar, në kushtet e emergjencës së krijuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT NDËRMINTOROR
TË EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINTËR
Edi Rama**